



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIK MALLAKASTËR

Ballsh më, 28.05.2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesuesi i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes 14:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 11 anëtarë.

Të pranishëm nga administrata: Z. Guri Nuhaj, Z. Fitim Baraj, Znj. Marjola Shehaj, Znj. Kleidja Hoxhaj, Znj. Elilda Dishaj, Z. Erjon Çelaj, Z. Besmir Selami, etj.

Mbledhja hapet me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 24.04.2026.
3. Projektvendim Nr. 25: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Kush është dakord me këtë rend dite?

Hidhet në votim, votojnë 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën dy të rendit të ditës, për miratimin e procesverbalit të mbledhjes datë 24.04.2026. Lexohen vendimet Nr. 22, 23, 24.

Vendim Nr.22: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Vendim Nr.23: Për miratimin e rregullores të komisionit këshillimor për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Mallakastër.

Vendim Nr.24: Për miratimin e anëtarëve të komisionit këshillimor për titujt vendor të nderit, emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Mallakastër.

Kalojmë në pikën tre, projektvendimi Nr. 25, Për trajtimin e familjeve me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%, nëse keni pyetje, diskutim ose sugjerim, jeni të mirëpritur.

Znj. Sabire Hoxhaj: Punonjësit i kanë parë dosjet e personave që janë në listë që kështu jemi dakord.

I shtohet një anëtar mbledhjes.

E hedhim në votim, votojnë 12 pro, 0 kundër, Miratohet.

Nëse keni diçka tjetër më thoni.

Znj. Suzana Malaj: - Te palestra e shkollës, në një fushë të vogël volejbolli na duhet një tapetë.

Z. Guri Nuhaj: - Bëjeni kërkesën me shkrim, sepse këto janë kërkesa që duan investime.

Z. Ledjon Salaj: - Dua të di nëse është shtuar në organikë një punonjës mirëmbajtje për në Greshicë.

Z. Besmir Selami: - Po, është e vërtetë që nuk ka një punonjës për atë zonë, por po mundohemi t'a mirëmbajmë zonën me këto punonjës që kemi.

Znj. Pajtime Liçaj: Në Hekal, te çezma e Koliboqit, ka nevojë për 2m3 beton aty afër ullinjve, sepse është e rrezikshme.

Z. Guri Nuhaj: - Do kontaktojmë direkt kompaninë që ka mirëmbajtjen e asaj rruge, që të merren masa.

Z. Përparim Bengaj: - Çfarë do të bëhet me kërkesën e Z. Faik Avdulaj?

Znj. Marjola Shehaj: Nga ana ligjore i ka plotësuar dy vjet banesë sociale pra me qera të paguar nga bashkia, tani të shohim nëse do të gjejnë ndonjë mundësi tjetër.

Mbledhja mbyllet këtu, duke ju falenderuar për pjesëmarrjen!

Mbajtës i Procesverbalit
Sekretar Këshilli

Zinaida Ahmetaj

